

**Aneksi A****SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

| Nr. | Pozicioni i punës                                                  | Struktura e interesuar / Forca                                               | Vendi ku ndodhet | Lloji i kontratës së punës | Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve |            | Afati i aplikimit |            |
|-----|--------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|------------------|----------------------------|-----------------------------------------|------------|-------------------|------------|
|     |                                                                    |                                                                              |                  |                            | Me dosje                                | Intervista | Fillimi           | Mbarimi    |
| 1   | <b>“Specialist” në Sektorin e Legjislacionit dhe Përfaqësimit.</b> | Reparti Ushtarak nr.6015,në Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve | Tiranë           | Pa afat                    | Po                                      | Po         | 21.01.2026        | 27.01.2026 |

Formulari nr. 1

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. Pozicioni i punës:</b> “Specialist” në Sektorin e Legjislacionit dhe Përfaqësimit, në Drejtorinë e Legjislacionit dhe Licensave.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>2. Kodi i pozicionit:</b> N/A                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <b>3. Reparti/Institucioni:</b> në Autoritetin e Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Reparti Ushtarak nr.6015.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <b>4. Vendi:</b> Tiranë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>5. Paga:</b> VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <b>6. Lloji i kontratës së punës:</b> Pa afat                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b>7. Data e fillimit të aplikimit:</b> 21.01.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>8. Data e mbylljes së aplikimit:</b> 27.01.2026                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b>9. Mënyra e aplikimit:</b><br><br>Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën <a href="http://www.mod.gov.al">www.mod.gov.al</a> . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do të dërgohet, në adresën:<br><br><i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i><br><br><i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i><br><br><i>Tiranë</i> |

## 10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [\(linku: Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit\)](http://www.mod.gov.al)

## 11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: **Specialist.**
- b. Arsimi : Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike
- c. Kualifikimi: Diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë.
- d. Trajnimi: Preferohen të kenë trajnime në fushë profesionale .
- e. Eksperienca në Punë: Eksperiencë pune në fushën profesionale.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira të punës në grup dhe të përdor programeve kryesore të kompjuterit, Microsoft Office.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Të plotësojë kriteret për tu pajisur me certifikatë të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikatë Sigurie "Secret".

**Përshkrimi i punës:** Rregjistron aplikimet e subjekteve tregtare publike apo private, për marrjen e liçensave, autorizimeve, dhe dokumentave të tjerë ligjorë të lëshuara nga AKSHE si dhe mban rregjistrin e kompanive të cilat janë të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

**Detyrat kryesore:**

- Hartimi, azhornimi dhe propozimi i projektakteve ligjore dhe nënligjore si dhe zbatimi i legjislacionit në fushën e kontrollit të import - eksporteve të mallrave ushtarake si dhe atyre me përdorim të dyfishtë.
- Dhënia e mendimeve juridike mbi legjislacionin e institucioneve të linjës, veprimtaria e të cilave ndërthuret me veprimtarinë e AKSHE-së.
- Ndjekja e proceseve gjyqësore në të cilat AKSHE është palë e paditur apo paditëse në të gjitha shkallët e gjykimit.
- Hartimi i procedurave për marrjen e masave administrative për subjektet tregtare ndaj të cilave janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve.
- Merr në shqyrtim dosjen e aplikimit të subjekteve tregtare për t'u pajisur me licensa importi/eksporti të mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë si dhe dokumenta të tjerë ligjorë sipas dispozitave të legjislacionit për kontrollin shtetëror të mallrave ushtarake dhe atyre me përdorim të dyfishtë.
- Përgatit korrespondencën me subjektet mbi plotësimin e dokumentacionit deri në lëshimin e liçensave/dokumentave të tjerë ligjorë sipas kërkesës së këtyre të fundit.
- Mban përgjegjësi për respektimin e procedurave dhe afateve të shqyrtimit të ankesave administrative

**13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

**Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

**Intervista** zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.